



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM

“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TRANSMETIMI AUDIO ANALOGE”

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio analoge”, miratuar me vendim nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, si dhe vendimit nr. 78, datë 22.07.2026 të AMA-s, “Për përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio dhe çeljen e garës për dhënie të 1 (një) licence të transmetimit audio analoge”, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidatave për dhënie të 1 (një) licence transmetimi audio analoge të përbërë nga:

- a. licenca e shërbimit të programi audio;
- b. licencë për ndërtimin e operimit të rrjetit analog.

Për zonat e mëposhtme:

Nr	Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pikat e transmetimit	Frekuenca (MHz)
1.	Qarku Shkodër	Audio Analoge	Midë; Tarabosh	99.3 98.6

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë transmetimi audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, **brenda datës 31.08.2026, ora 10:00.**

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidatave, që përfshin:

- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënie të licencës së transmetimit audio analoge”, e ndryshuar;
- Kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi;
- Kriteret teknike për ofrimin e shërbimit audio përfshirë frekuencën/frekuencat dhe pikën/pikat e transmetimit për zonën e shërbimit;
- Pagesat për licencën, tarifat përkatëse dhe mënyrën e pagesës së tyre.



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, 1010, Tiranë | www.ama.gov.al
Tel. +355 4 2233006 | Email. info@ama.gov.al

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA, pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datë 31.08.2026, ora 10:00, në mjediset e AMA-s***, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.